

Hapet thirja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Janinës, Greqi, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për praktikë për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Janinës në Greqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.uoi.gr/en/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për praktikë në Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe me Publikun në Universitetin e Janinës;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;

- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (3 muaj);

- Master (3 muaj);

Fushat:

- Informatikë;

- Informatikë Ekonomike;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze / greke);
 - Kopje e Pasaportës;
 - Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / greke);
 - Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / greke);
 - Letër Motivimi në gjuhën angleze / greke;
 - Certifikatë e gjuhës së huaj (gjuha Angleze, niveli C);
- *Preferohet që studentët të jenë njohës edhe të gjuhës greke (minimalisht niveli B1);

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze / greke);
 - Kopje e Pasaportës;
 - Vërtetim studentit e nivelit bachelor dhe master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / greke);
 - Listë notash e nivelit bachelor dhe master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / greke);
 - Diplomë e nivelit Bachelor;
 - Letër Motivimi në gjuhën angleze / greke;
 - Certifikatë e gjuhës së huaj (gjuha Angleze, niveli C);
- *Preferohet që studentët të jenë njohës edhe të gjuhës greke (minimalisht niveli B1);

Afati për aplikim: **14 Shkurt 2022**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al. Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!